



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Shkurt 2021

Nr: 26

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË POGRADEC, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË G99,  
Z. SOKOL RESHIT KUME**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, paragrafi 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës

**VËREN:**

Me shkresën nr. 5482/2 prot., datë 15.12.2021, Këshilli i Bashkisë Pogradec, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës nga këshilltari zj. Adelina Mehmet Mema, propozuar nga subjekti Partia G99.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë G99, është kandidati me numër rendor 02, z. Eridiol Sulejman Alla.



Këshilli i Bashkisë Pogradec me shkresën nr. 01 prot., datë 05.01.2021, me lëndë dërgim informacioni, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se z. Eridiol Sulejman Alla, rezulton që nuk është banues në qytetin e Pogradecit.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vijoi procedurën e mëtejshme të konstatimit të kandidatit të radhës, sipas listës shumemërore të Partisë G99, në përputhje me parashikimet neneit 164, paragrafi 2, ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë G99, është kandidati me numër rendor 03, zj. Shpresa Xhafer Alla.

Me shkresën nr. 10 prot., datë 04.01.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Pogradec, zj. Shpresa Xhafer Alla, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Zj. Shpresa Xhafer Alla, me shkresën nr. 248 prot., datë 11.01.2021, njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se jep dorëheqjen nga vazhdimi i procedurave.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, do të vazhdojë procedurën me kandidatin e radhës të listës shumemërore të Partisë G99, për këshillin e bashkisë Pogradec.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë G99, është kandidati me numër rendor 04, z. Sokol Reshit Kume.

Me shkresën nr. 287 prot., datë 13.01.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Pogradec, z. Sokol Reshit Kume, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia G99, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 003 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, z. Reshit Sokol Kume, në këshillin e bashkisë Pogradec, rezulton se, në pyetjes nr. 8 të formularit të vetëdeklarimit “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?, I është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se, ka jetuar në Katerin, Greqi, për pushime, për periudhën tetor 2019 deri më dhjetor 2019. “

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja “b” dhe paragrafi 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 447 prot., datë 19.01.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 448 prot., datë 19.01.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, z. Sokol Reshit Kume, në këshillin e bashkisë Pogradec, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Pogradec, z. Sokol Reshit Kume.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 528/1 prot., datë 21.01.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Sokol Reshit Kume, në këshillin e bashkisë Pogradec, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar paragrafit 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, të dhënat e kandidati për anëtar z. Sokol Reshit Kume, në këshillin e bashkisë Pogradec, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, paragrafi 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

## V E N D O S:

1. Z. Sokol Reshit Kume, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Pogradec, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Pogradec, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë G99, z. Sokol Reshit Kume.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet  
Punoi:  
I.Osmanaj \_\_\_\_\_  
B.Kodra \_\_\_\_\_  
M.Koja \_\_\_\_\_  
Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021

